



Datë: 01.09.2025
Numër Protokolli: 5849/2025

A.nr.1313/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj–Demi anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1313/2025 të datës 08.07.2025 të parashtruar nga ankuesi A.K, kundër organit të punësimit: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1313/2025, e datës 08.07.2025, e parashtruar nga ankuesi A.K.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 2199 të datës 12.06.2025, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për kandidatin fitues të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017318, për pozitën “*Drejtor i Departamentit për Arsimin e Lartë dhe Shkencës*”.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, A.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 08.07.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4562/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017318, për pozitën e punës “*Drejtor i Departamentit për Arsimin e Lartë dhe Shkencës*”, të shpallur me datë 21.03.2025, me pretendimet ankimore lidhur me shkeljen sa i përket fillimit të testimit me shkrim respektivisht shtyrjen e fillimit të testimit, mungesën e anëtarëve të komisionit në përbërje të plotë si dhe favorizimin e kandidatit fitues.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (tutje MASHT), ndërsa kjo e fundit, më datë 06.08.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4562/2025, të datës 08.07.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimit të ankesës të datës 08.07.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.07.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 08.08.2025, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Ftesë për test me shkrim, të datës 02.06.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Kërkesë e datës 04.07.2025; Kërkesë për qasje në dokumente lidhur me procesin e vlerësimit, e datës 30.06.2025; Formulari i vlerësimit të esesë, i datës 01.07.2025; Njoftim i datës 04.07.2025; Konkursin me numër reference RN00017318, i datës 21.03.2025; Lisat e aplikantëve (aprovuar dhe refuzuar); Vendim për themelimin e komisionit me numër Nr.2-1786, të datës 08.05.2025; Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit me numër Nr.2-215, të datës 03.06.2025; Akt emërimi i datës 11.09.2015; Vendim për transferim të përhershëm me numër Ref.KM-153/24, të datës 08.04.2024; Kërkesë e datës 04.04.2024; Vendim me numër Ref.KM-99/24, i datës 05.03.2024; Vendim me numër Ref.KM-325/23, të datës 08.09.2023; Vendim me numër Nr.08/130, i datës 22.02.2023; Akt emërimi me numër Nr.48/2024, i datës 05.09.2024; Akt emërimi me numër Nr.07/2024, i datës 26.11.2024; Akt emërimi me numër Nr.130/2024, i datës 01.10.2024; Kërkesë e datës 20.03.2025; Formulari i përshkrimit të punës; Pyetjet e hapura për testim individual; Njoftim për intervistë me gojë, i datës 10.06.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë, e datës 11.06.2025; Njoftim për kandidatin fitues, të datës 12.06.2025; Aplikacionin me datë aplikimi 16.04.2025, të kandidatit A.K, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 03.04.2025, të kandidatit A.K, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 20.04.2025, të kandidatit B.K, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 15.04.2025, të kandidatit M.M, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 17.04.2025, të kandidatit S.K, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 26.03.2025, të kandidatit S.LL, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 23.03.2025, të kandidatit DH.Ç, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi të datës 26.03.2025, të kandidatit D.T, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 15.04.2025, të kandidatit E.S, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionet me datë aplikimi 22.03.2025, të kandidatit F.R, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 31.03.2025, të kandidatit L.B, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 20.04.2025, të kandidatit M.K, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 24.03.2025, të kandidatit N.K, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 12.04.2025, të kandidatit N.B, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 07.04.2025, të kandidatit R.H, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 10.04.2025, të kandidatit R.B, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa është e pranueshme dhe është lëshuar në shqyrtim meritore dhe ka gjetur se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se MASHT, më datë 21.03.2025 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00017318, për pozitën e Kategorisë së Mesme Drejtuese "Drejtore të Departamentit për Arsimin e Lartë dhe Shkencës", me afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri me datë 20.04.2025.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 16 kandidatë, ku prej tyre 6 kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesin i cili ka marrë pjesë ë vetëm në testim me shkrim ku ka arritur gjithsejtë 36,2 pikë prandaj nuk ka kaluar testimin me shkrim.

Ndërsa, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MASHT, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, gjegjësisht me datë 12.06.2025 ka publikuar Njoftimin për kandidatin fitues, nga i cili njoftim rezulton se kandidati B.K, me gjithsejtë 81,6 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, është shpallur kandidat fitues për pozitën *Drejtor i Departamentit për Arsimin e Lartë dhe të Shkencës në MASHT*.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill, me pretendimet sikur janë shënuar në hyrje të këtij arsytimi kërkon anulimin e kësaj procedure.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00017318, për pozitën e kategorisë së mesme drejtuese *Drejtor i Departamentit për Arsimin e Lartë në MASHT* dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë:

Arsimimi i kërkuar: *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Ekonomi, Juridik, Administratë Publike.*

Kërkesat specifike: Nuk ka.

Përvoja e punës e kërkuar: *Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërën nga kërkesat në vijim: 1.3 vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose dy (2) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose 3. një 1 vit përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoratës).*

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se kërkesat e përgjithshme formale të sapo theksuara janë vendosur në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht Shtojcës Nr.1/2 lidhur me Përshkrimin e përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Mesëm si dhe po ashtu Komisioni për Pranim në Shërbimin Civil ka qenë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore tjera ankimore i' u referua legjislacionit në fuqi, respektivisht Nenit 44 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe dispozitave të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht:

-Nenit 7, ku përcaktohet se: *1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.*

-Nenit 9 ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë*

(70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimi, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimi. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim....; dhe se nga analizimi i shkresave të lëndës kandidatëve lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit rezulton se vlerësimi i testit me shkrim është realizuar në mënyrë elektronike, dhe se pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për gjithë kandidatet, ndërsa nga provat e pranuar nga ankuesi, si dhe organi i punësimit, rrjedh se ankuesi ashtu sikurse kandidati i përzgjedhur i janë nënshtruar testit me shkrim, si rrjedhojë ankuesi në fazën e testimit me shkrim ka arritur t'i mbledh 36,2 pikë, respektivisht 28 pikë nga përgjigjet për pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë prej 50 pikëve sa është maksimumi dhe 8,2 pikë prej 20 pikëve sa ishte maksimumi i pikëve për esenë me shkrim, prandaj ankuesi nuk ka arritur të kalojë testimin me shkrim dhe ti nënshtrohet intervistës me gojë, sikurse parashihet me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 9 paragrafi 4 ku përcaktohet se: 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.

Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar pretendimin e ankuesit lidhur me vonesën e fillimit të testimit dhe nga shkresat e lëndës të gjeneruar nga SIMBNJ dhe ka konstatuar se testimi ka filluar në ora 10:13, prandaj kjo kohë është në kuadër të përgatitjeve për fillim të testimit dhe nuk ka ndikuar në dëmtimin e procesit apo favorizimin e ndonjë kandidati që ka marrë pjesë në këtë procedurë, gjithashtu nga shkresat e lëndës nuk konstatohet pretendimi i ankuesit se kandidati që është shpallur fitues është favorizuar në ndonjë mënyrë, kështu që pretendimet e ankuesit janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara në argumente ligjore në fuqi.

Tutje, Kolegji i Këshillit, në kontest të shqyrtimit të kësaj procedure të rekrutimit dhe duke u bazuar në dispozitat e sipër theksuara ligjore, ka analizuar aplikacionin e kandidatit B.K, të datës 20.04.2025, nga i cili rezulton se i njëjti si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor, ka bashkangjitur Diplomën me Nr.670 të lëshuar me datë 20.07.2008, nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Filozofik, me anë të cilit dokument dëshmohet se i njëjti më datë 14.02.2008 ka mbaruar studimet themelore universitare në Drejtimin e Sociologjisë dhe ka marrë gradën Bachelor i Sociologjisë, Diplomën nr.220 të datës 31.05.2013 me të cilën dëshmohet se ka marrë gradën Master i Sociologjisë me datë 22.03.2013. Ndërsa sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës së punës profesionale dhe drejtuese, kandidati në fjalë ka bashkangjitur këtë dokument: Vërtetimin e datës 28.03.2025 me nr.prot 197/2025 të lëshuar nga Gjimnazi Xhevdet Doda me të cilën dëshmohet se kandidati B.K nga 01.12.2018 deri më datë 08.02.2024 ka mbajtur pozitën e Zv. Drejtorit të shkollës, ndërsa nga data 09.02.2024 deri më datën 08.08.2024 ka ushtruar pozitën e drejtorit të shkollës, kandidati B.K sipas vërtetimit të lartshënuar ende vazhdon në pozitën e Zv.drejtorit në Gjimnazin Xhevdet Doda në Prishtinë.

Andaj, bazuar në të gjeturat e sipër theksuara, Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidati B.K, ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale, të përcaktuara me shpalljen e konkursit me numër RN00017318, për pozitën e Kategorisë së Mesme Drejtuese *Drejtor i Departamentit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës në MASHT*, dhe duke qenë se i njëjti ka kaluar me sukses testin me shkrim dhe intervistën me gojë duke mbledhur më së shumti pikë nga kjo procedurë rekrutimi, si rrjedhojë i njëjti ka fituar të drejtën për tu shpallur kandidat fitues, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NJMBNJ, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 2199 të datës 12.06.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për kandidatin fitues të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017318, për pozitën *“Drejtor i Departamentit për Arsimin e Lartë dhe Shkencës*, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1313/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.K;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MASHT; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.